

TË DREJTAT DHE



FËMIJËT

POPULLI DEMOKRATIK

OMERI (9), ENSARI (9), ORGESA (9), TUANA (9), ERISA (9), FLONJA (9)



Unë kam të drejtë të shkoj në shkollë

Lexues të dashur, ne sot do t'iu tregojmë më shumë për demokracinë

Do të fillojmë së pari me elementet e demokracisë. Në atë vend ku ka demokraci, të gjithë njerëzit janë të barabartë dhe nuk trajtohen ndryshe, pavarësisht racës, gjinisë apo fesë.

Ne duhet të tolerojmë njëri-tjetrin, dhe kur ndonjë njeri toleron dikë për ndonjë gabim të tij është gjë e mirë. Liri quajmë kur çdo njëri bën dhe zgjedh atë që dëshiron. Demokracia ndryshe quhet edhe liri.

Kjo fjalë rrjedh nga gjuha greke, dhe për herë të parë u përmend në kryeqytetin e Greqisë Athinë, në vitin 507 para erës sonë. Pra „demos“ do të thotë popull dhe „kratos“ do të thotë pushtet.

Rregullat dhe ligjet janë disa obligime që të gjithë njerëzit duhet t'iu përmbahen. Rregullat dhe ligjet ndimojnë njerëzit në tri qëllime: Të ruajmë shëndetin dhe sigurinë, të ruajmë pronën, të shkojmë mirë me të tjerët.

Njerëzit për një jetesë më të mirë duhet të zbatojnë rregullat dhe ligjet.

Disa të drejta dhe përgjegjësi janë: ne kemi të drejtë të shkollohemi, ne kemi të drejtë të jetojmë, të shprehim mendimin lirshëm, etj. Ndërsa disa nga përgjegjësitë tona janë: t'i bëjmë detyrat, t'i respektojmë rregullat e trafikut, të mësojmë, të mbrojmë ambientin, të mos vrapojmë në koridoret e shkollës, të respektojmë mësuuesen, etj. Nëse ne nuk zbatojmë këto rregulla dhe

ligje, mund të ndodhë që pa pasur tabela udhëzuese makinat mund të përplasen mes vete. Kurse, nëpër dyqane kur nuk respektohet radha njerëzit mund edhe të lëndohen dhe grinden.

Kjo do të thotë që ligjet na lehtësojnë jetën tonë.



Ligjet në demokraci janë të barabarta për të gjithë



Njoftohuni me autorët

POPULLI VENDOS PËR TË ARDHMEN E VET

NARRON (9), RON (10), POEMA (10), LEJLA (9), ANESA (9), LORETA (9)

Më poshtë do të mësoni për procesin zgjedhor në Republikën e Kosovës

Zgjedhjet janë një proces i rëndësishëm i vendit. Me anë të zgjedhjeve, populli ushtron fuqinë e vet duke i zgjedhur deputetët që do të na përfaqësojnë në Kuvend. Ne kemi të drejtë vote nga moshën 18 vjeçare.


Ne bëjmë zgjedhje edhe më herët në jetën e përditshme, për shembull, përmes votimit të zgjedhim kryetarin e klasës, por për zgjedhjet qendrore ose parlamentare votojmë në moshën 18 vjeçare. Kjo për arsye se jemi më të pjekur dhe e vlerësojmë më mirë se kë duhet ta votojmë.

Në Republikën e Kosovës janë edhe zgjedhjet lokale, ku zgjedhen kryetarët e komunave.

Është shumë e rëndësishme që të gjithë të marrin pjesë në zgjedhje, sepse kështu e ndërtojmë edhe më mirë demokracinë.



Gazetarët e vegjël




Përmes votimit populli vendos për të ardhmen e vet



Kemi dy lloje të zgjedhjeve: qendrore dhe lokale



Në moshën 18 vjeçare kemi të drejtën e votës



Të gjithë duam të jetojmë në demokraci

NDARJA E PUNËVE NË NJË VEND DEMOKRATIK

SHUAJB (9), DIONA (9), ALBERON (9), LEA (10), ERIS (9)

Ne sot kemi biseduar se sa e rëndësishme është t'i ndajmë punët dhe të punojmë së bashku

Çdo popull ka mënyrën e tij të udhëheqjes. Demokracia është formuar që t'i ndajmë punët.

Demokracia në Kosovë zbatohet nga qytetarët.

Ne duhet të punojmë së bashku, sepse nëse vetëm një njëri punon ai do të lodhet.

Në një vend demokratik, pushteti ndahet në tri pjesë.

Ato janë: Pushteti Legjislativ, i cili ushtrohet nga Kuvendi, Pushteti Ekzekutiv, i cili ushtrohet nga Qeveria dhe pushteti Gjyqësor, i cili ushtrohet nga Gjykata.

Gjykatat ndahen në tri lloje: Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Në gjykatë punojnë: gjykatësi, prokurori, gjykatësi mbrojtës.

Ne kemi Ministri të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministri të Shëndetësisë, Ministri të Punëve të Jashtme dhe të Brendshme etj.

Këto ministri punojnë në Qeveri, nën udhëheqjen e Kryeministrit.

Qeveria propozon ligje, të cilat votohen nga deputetët e Kuvendit të Kosovës, dhe për t'u miratuar këto ligje, duhet të jenë mbi 61 vota.


Këtë artikull do ta përmbyllim me një fjalë të urtë popullore e cila thotë: „Bashkimi bën fuqinë“.




Bashkëpunimi në grup



Pushteti i ndarë në tri pjesë



Institucionet demokratike




Pushteti legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor



Ne duhet t'i ndajmë punët në mënyrë të barabartë

KUVENDI YNË

AGNESA (9), UNEJSA (9), ORIN (9), OLTİ (10), ELIRA (8)



Ne mësuam për Kuvendin e Kosovës, dhe mendojmë se Kuvendi është shumë i rëndësishëm për një shtet demokratik siç është Kosova

Kuvendi ndryshe quhet „Shtëpia e popullit“ sepse aty punojnë përfaqësuesit e popullit.


Kuvendi ka shumë detyra, e disa prej tyre janë t'i propozojnë ligjet dhe mund t'i miratojnë apo mos t'i miratojnë ato, zgjedh Qeverinë dhe e kontrollon atë, zgjedh Presidentin, etj.



Gjatë punimit të artikullit

e enjte mbledhen deputetët për të mbajtur seancë plenare. Në seanca plenare deputetët diskutojnë, votojnë ligje, propozojnë ligje e kështu me radhë. Republika e Kosovës ka Kuvendin e saj ku zhvillohen të gjitha ato që i përmendëm më lart.

Ne jemi të lumtur që Kosova ka Kuvendin e saj, dhe kemi 120 deputetë të cilët na përfaqësojnë dhe ata punojnë për të mirën tonë.



Në Kuvendin e Kosovës duke votuar

Në Kuvendin tonë ka etni të ndryshme, por të gjitha këto etni kanë nënshtetësi kosovare.


Siç e kemi cekur më lart, në Kuvend punojnë deputetët. Aty punojnë 120 deputetë, ku 100 janë qytetarë shumicë, e 20 të tjerë janë komunitete jo shumicë.

Sipas ligjit të Kosovës, 30% e ulëseve janë të garantuara për gratë. Kuvendi i Republikës së Kosovës punon prej të hënës deri të premten.

Ditën e hënë mbledhet kryesia e Kuvendit, kurse ditën



Gazetarët e këtij artikulli



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësi:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Pjetër Bogdani“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IV-2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë